



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



04/ 8094 2022

RAPORTI I DËGJIMEVE BUXHETORE PËR DRAFT BUXHETIN 2023 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2024-2025

PROPOZIMET E QYTETARËVE LIDHUR ME KONSULLTIMET BUXHETORE PËR BUXHETIN E VITEVE 2023-2025 NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

Propozimet nga dëgjimi i parë buxhetor me “Hendikos”:

1. Ndërtimi i trotuareve me pjerrina pasi që qytetarët me karroca hasin në vështirësi për t'u kyç në trotuare. *(Ky projekt propozim ka hyrë në kuadër të projektit nr. 9 me kod 51576).*
2. Subvencionimi i Shoqatës “Hendikos” për rehabilitim, mundësimi i një terapeuti ose dhënia e terapevite të ndryshme 2,3 herë në javë. *(Kjo kërkesë i takon natyrës së kategorisë mullra dhe shërbime, të cilat kërkesa i kemi planifikuar t'i zbutojmë).*
3. Ofrimi i shkollimit fillor dhe të mesëm për këtë kategori. *(Komuna jonë nuk ka mundësi t'a plotësoj këtë kërkesë por në bashkëpunim me komunën e Kaçanikut do shikojmë cilat janë mundësitë për t'a realizuar).*
4. Sigurimi i barnave më të shtrejtta *(Lista e barnave esenciale sigurohet prej Ministrisë, megjithatë për shoqatën “Hendikos” disa nga barnat do t'i sigurojmë me procedurë të veçantë që nuk bëjnë pjesë barnat esenciale).*
5. Mbikalimet paraqesin vështirësi, a ka ndonjë plan rreth tyre. *(Kjo është në kompetencë të Infrakos dhe Trainkos dhe do të realizohet nga ato).*
6. Restoranti i ri që do të hapet afër ETC a do të bëjë Komuna një lift apo Hendikos duhet ta bëjë një kërkesë për lift. *(Kjo nuk është në kompetencë të Komunës, por, zyrtarët Komunal mundë t'iu ndihmojnë në përgatitjen e dokumentacioneve).*
7. Kërkesë për një fizioterapeut të QKMF. *(Komuna, përveç fizioterapeutit ka mungesë të personelit mjekësor që janë të shumtë, si stomatologë, psikologë, logopedë, etj. Por do të shihet mundësia që herë pas herë të ofrohet fizioterapi).*
8. Sigurimi i transportit për personat me autizëm gjatë periudhës së dimrit kur mbajnë konsultime. *(Do të shikojmë mundësitë për ta realizuar këtë kërkesë).*

Propozimet nga dëgjimi i dytë buxhetor me qytetarët:

1. Ndërtimi i shkallëve tek varrezat të Lagja e Meliqve, për shkak të pjerrtësisë së vendit. *(Ky propozim ka hyrë në kuadër të projektit nr. 32 me kod 51071).*

2. Rregullimi këndit të lojrave përballë Komunës. *(Gjatë vitit 2023 kemi bërë planifikimin e të njëjtin projekt por në fshatin Gorancë sepse nuk kemi mjete të mjaftueshme edhe për në lokacione tjera).*
3. Të bëhet Dezinfektimi, Deratizimii dhe Dezinsektimi që nuk është bërë kurrë në Han të Elezit. *(Kjo do të kryhet nga kategoria Mallra dhe Shërbime).*
4. Vendosja e koshave të mbeturinave në çdo lagje. *(Do të vendosen në të gjitha lagjet në vitin 2023).*
5. Të vazhdohet pastrimi i rrugëve me ujë. *(Jemi në faza të diskutimit me menaxhmentin e fabrikës së ujit për të vazhduar pastrimin i rrugëve sidomos në sezonin e verës).*
6. Tashmë nuk po dihet fati i banesave të vjetra në Han të Elezit, dhe nëse nuk parashihet prishja e tyre, a do të ishte e mundur ngjyrosja apo vendosja e mureleve nëpër muret e banesave? *(E kemi pasur pikë në KPF mirëpo nuk ka kaluar, fasada nuk preferohet sepse në atë mënyrë maskohen ndërtesat dhe njerëzit nuk i shohin rreziqet që ju kanosen).*
7. Kërkesë prej nxënësve dhe studentave me j'ua siguruar transportin për Ferizaj dhe Prishtinë ose ndërtimi i stacionit të autobusëve. *(Ndërtimi i stacionit të autobusëve nuk është në kompetencë të Komunës, ndërsa për sigurimin e transportit për ato destinacione nuk kemi mjete të mjaftueshme buxhetore).*

Propozimet nga dëgjimi i tretë buxhetor me gratë:

1. Kërkesë për një buxhet të veçantë për gra ku do të caktohen persona të veçantë që do ndëmarrin aktivitete të ndryshme. *(Buxhet enkas për gra nuk mundemi të ndajmë sepse kemi një buxhet shumë të limituar, megjithatë mundë të organizojmë aktivitete dhe punëtori të ndryshme për gratë).*
2. Kërkesë rreth punëtorive të ndryshme nga gra të profesioneve të ndryshme *(Kemi planifikuar mbajtjen e punëtorive të ndryshme).*
3. Fuqizimi i grave nëpërmjet organizimit të punëtorive të ndryshme. *(Kemi planifikuar mbajtjen e punëtorive të ndryshme).*
4. Organizimi i punëtorive të ndryshme që kanë të bëjnë me soft skills. *(Kemi planifikuar mbajtjen e punëtorive të ndryshme duke përfshirë edhe për soft skills në bashkëpunim me organizata tjera).*
5. Pjerrëtësina nëpër trotuare *(Ky projekt propozim ka hyrë në kuadër të projektit nr. 9 me kod 51576).*
6. Sjellja e një gjinekologe në QKMF – *(Nuk kemi aprovim të stafit shtesë në Shëndetësi, po kemi planifikuar me angazhuar një gjinekologe me kontrat mbi vepër).*
7. Ndërtimi i një aneksi të çerdhja sepse kërkesa për regjistrim të fëmijëve është rritur. *(Do ta parashikojmë për vitet në vijim sepse për vitin 2023 nuk kemi mjete të mjaftueshme buxhetore).*
8. Kërkesë për një kalim nga çerdhja për me lidh me pjesën nën hekurudhë, për automjete, sepse për këmbësorë ekziston jo formalisht një kalim aty. *(Kjo kërkesë ka hy në listen e projekteve me nr. 30 me kod 51060).*

Propozimet nga dëgjimi i katërt buxhetor në fshatin Gorancë:

1. Prioritet kryesor është kanalizimi në pjesën perëndimore prej te varrezat deri te pompa e cila e furnizon fshatin me ujë, e ku dihen pasojat që i kemi pasur gjatë këtij viti – nga ndotja e ujit. *(Ky propozim ka hyrë në projektin nr. 10 me kod 51581).*
2. Rryma duhet të kyçet nga rrjeti i xeherores ACHRO. *(Ky projekt është në kompetencë të KEDS-it),*
3. Në rrugën “Pavarësia”, një lagje e fshatit i ka shtyllat prej drurit dhe janë shumë të dëmtuar-vetëm telat i mbajnë shtyllat. Duhet ë ndërrohen me shtylla të betonit dhe të vendosen kablllo bistek. *(Kjo kërkesë është në kompetencë të KEDS-it)*
4. Bypass-rrugë alternative prej Hanit të Elezit në Gllaboçicë duhet të largohet nga fshati. Duhet pjesa nëpër fushë të rregullohet si alternative për tu eliminuar kamionat nëpër fshat. Ka shumë lëvizje të komunikacionit nëpër fshat dhe lëvizin fëmijët e shkollës dhe popullata që janë përherë të rrezikuar. *(Ky projekt ka kosto të madhe dhe pronat në atë zone janë private duhet ose të shpronësohen ose të merren pëlqimet e pronarëve).*
5. Asfaltimi i rrugës për Krevenik. *(Ky propozim ka hyrë në projektin nr. 17 me kod 47270).*
6. Disa rrugica janë pa kubëza. *(Ky propozim ka hyrë në projektin nr. 9 me kod 51576).*
7. Në fshatin Rezhancë deri te varrezat duhet të bëhet asfaltimi i rrugës me gjatësi 400m. *(Ky propozim ka hyrë në projektin nr. 11 me kod 51720).*
8. Te lagjja Huneli , varrezat duhet të rrethohen afërsisht 200m. *(Do të hy në listën e projekteve kapitale).*
9. Të përfundohet projekti te varrezat e fshatit Gorancë, të bëhet shtrimi me kubëza të betonit prej te hyrja deri në fund të varrezave, te dera poshtë. *(Ky propozim ka hyrë në projektin nr. 9 me kod 51576).*
10. Mbjellja e pishave *(Ky propozim është në kompetencë të Agjensionit Pyjor të Kosovës).*
11. Te vendi Gjurma të bëhet një vend rekreativ ose ndonjë pishinë si formë liqeni *(Nuk kemi mjete të mjaftueshme për këtë projekt).*
12. Rregullimi i një parku dhe me u monitoru me kamera, ku kapet edhe AMF-ja edhe parku, shkak i personave të pandërgjegjshëm që shpesh po shkatërrojnë objektet. *(Ky propozim ka hyrë në projektin nr. 24 me kod 51722).*
13. Ndonjë fitness park ose diçka të tillë. *(Mundë të parashihet me projektin nr. 24 nëse gjejmë ndonjë donator për paisjet).*
14. Të hapet një rrugë të cilën e kemi shfrytëzuar në kohën e luftës së UÇK-së, prej te varrezave deri te lapidari i Xhevdet dhe Feriz Gurit. *(Për vitin 2023 nuk kemi mjete buxhetore edhe për këtë propozim po do ta marrim parasysh vitet në vijim).*

Propozimet nga dëgjimi i pestë në fshatin Krivenik:

1. Kërkesë për ndriçimin publik, nuk ka as shtylla elektrike në shumë vende, e të tjera plot janë rrëzu shkak i erës dhe janë prej druri, e për çdo ditë problem me rrymë po kemi. *(Shtyllat elektrike është kompetencë e KEDS-it dhe këtu munden me u angazhu të gjithë administratorët për me insistu, kurse komuna e kryen pjesën e ndriçimit e dritave).*

2. Kërkesë për shtrim me kubëza betoni si dhe rregullimi i kanalizimeve. (Këta propozime kanë hyrë në projektet nr. 9 me kod 51576 dhe nr. 10 me kod 51581).
3. Kërkesë për rregullimin e ndriçimit publik. (ka hyrë në projektin nr. 1 me kodin 90573).
4. Kërkesë për asfaltim të rrugëve dhe ndërtimi i mureve mbrojtëse. (Këta propozime kanë hyrë në projektin nr. 11 me kod 51720 dhe në projektin nr. 14 me kod 50146).

Propozimet nga dëgjimi i gjashtë buxhetor në fshatin Seçishtë:

1. Kanali i ujitjes në Lloka që kushton diku 14 mijë €; (Ky propozim ka hyrë në projektin nr. 4 dhe është projekt i ri).
2. Pyllëzimi i Shullanit. (Ky propozim është në kompetencë të Agjensionit Pyjor të Kosovës).
3. Rregullimi i rrugës nërbregut, që është rruga që shkon rreth Lepencit, prej te kroi këtu deri te Kalist atje poshtë, ku s’paku me e shtru me zhavor, (Ky propozim është i kushtueshëm si dhe ato prona janë në kontest).
4. Rruga e burimit të lumit Lepenc (Ky propozim ka hyrë në projektin nr. 11 me kod 51720).
5. Penda në Sarasellë. (Ky propozim ka hyrë në projektin nr.6 dhe është projekt i ri).
6. Hapja e rrugës për në vorba – (Ky propozim ka hyrë në projektin nr. 11 me kod 51720).
7. Ndërtimi i një toaleti në aneksin e shkollës paralele në Seçishtë si dhe ndërtimi i mureve mbrojtëse – (Ndërtimi i toaletit është në procedurë e sipër ndërsa ndërtimi i mureve mbrojtëse ka hyrë në projektin nr. 14 me kod 50146).
8. Uji i pijes, kanalizimet, rruga e vorbës me u shtru me zhavor, rruga në Lozhë. (Uji i pijes ka hyrë në projektin nr. 2 me kod 47216, kanalizimet janë parashiku në projektin nr. 10 me kod 51581).
9. Gjenerator për shkollën në Seçishtë – (Ky propozim i takon kategorisë mallra dhe shërbime, që e kemi planifikuar për vitin 2023).

Propozimet nga dëgjimi i shtatë buxhetor në fshatin Paldenicë:

1. Ka shumë rrugë dhe rrugica që kanë mbetur pa shtrim me kubëza apo pa asfaltim si dhe të sigurohen shporta për mbeturina. (Ky propozim ka hyrë në projektin nr. 9 me kodin 51576 dhe në projektin nr 11 me kodin 51720, ndërsa sa i përket shportave të mbeturinave ky propozim i takon kategorisë mallra dhe shërbime nga Drejtoria e Shërbimeve Publike).
2. Mirëmbajtja e rrugës Hani i Elezit-Lagjja Ramuk-Paldenicë dhe duhen dy punëtorë që me u angazhu për këtë punë. (Kjo është në kompetencë të kompanisë N.P.L “Pastrimi” e cila kërkesë do të plotësohet në vazhdimësi).
3. Mirëmbajtja e rrugës për Paldenicë sidomos gjatë dimërit të hedhet kripë. (Ky propozim është aktivitet i rregullt gjatë dimrit i drejtorisë së Shërbimeve Publike, ku aktivitete të këtuilla do vazhdojnë edhe në vitet e ardhshme).
4. Zgjerimi i rrugës për Paldenicë tek pjesa kah Topojanët. (Ky propozim ka hyrë në projektin nr. 11 me kod 51720).

5. Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugës nga shkolla për në fshat. *(Do ta parashikojmë mirëmbajtjen edhe nga ajo rrugë).*
6. Propozoj që me u çel rruga kah policia për me dal për Paldenicë në rrafshë. *(Ky projekt ka një kosto shumë të madhe, momentalisht nuk kemi mundësi të ndajmë mjete pasi që janë disa projekte më prioritare).*
7. Rruga prej kroit të Paldenicës deri te Ramukt e ku mund të lidhte edhe kjo kodra e staneve. *(Ky propozim ka hyrë në kuadër të projektit nr. 11 me kod 51720).*
8. Procka prej te kroi i fshatit deri te Çupt, së paku te nënkalmi me u punu që mos me u mbledh uji kur bjen shi. *(Ky projekt ka hyrë në projektin nr. 15 dhe është projekt i ri).*
9. Rruga te përpjetëzja mbi çeshmen e Hetemit që me u zgjeru pak ajo rruga se është shumë ngushtë, po që duhet përgjithësisht një rregullim i rrugës Hani i Elezit-Dërmjak. *(Ky propozim ka hyrë në kuadër të projektit nr. 11 me kod 51720).*
10. Uji është problem në krejt Hanin e Elezit, jo veç në Paldenicë, por zgjidhje është procka që vjen prej Dërmjakut, me u bërë një liqen aty. *(Nuk kemi mjete të mjaftueshme për një projekt tjetër të ujit).*
11. Nënkalmi apo procka prej kodrës së Tushës dhe duhet me u bo një ndërhyrje që s’paku banorët me mujt me i punu tokat që i kanë poshtë autobanit, e mos me kalu mbi autoban që shpesh e kalojnë edhe në këmbë. po në këtë pjesë, kanalizimi ekziston por ka defekte, kalon nëpër proç, dhe ne shumica i kemi pusët/bunaret aty edhe duhet një ndërhyrje sa më e shpejtë në këtë çështje, që me evitu helmimin e ujit. *(Ky propozim ka hyrë në projektin nr. 11 me kod 51720 ndërsa projekti tjetër në lidhje me kanalizimin ka hyrë në projektin nr. 15 dhe është projekt i ri).*
12. Rruga Paldenicë-Llokme. *(Ky propozim ka hyrë në projektin nr. 11 me kod 51720)*
13. Parku i fshatit te pjesa poshtë shkollës fillore. *(Do të hy në listën e projekteve kapitale).*
14. Shkallët emergjente në shkollë – *(Ky projekt do të hy në listën e projekteve kapitale në vitet në vijim pasi që në vitin 2023 do të ndërtohen shkallët emergjente te shkolla e mesme “Dardania”).*
15. Pengesa gjatë marrjes së lejes për ndërtimin e shtëpive të reja. *(Jemi në fazat e hartimit të hartave zonale për të cilat do të organizojmë edhe konsultime publike).*